



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 2831 prot.

Tiranë, më 04.03 .2024

NJOFTIM

Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr. 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”, Statutit të TKOBAP të miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e TKOBAP-së”, **shpall audicionin për pozicionin e punës “Oboe e dytë me detyrim Korno angleze” pranë Drejtorisë së Operës dhe Filarmonisë.**

Për t’i dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për t’i krijuar mundësi pjesëmarrjes më të madhe në numër të konkurentëve, TKOBAP nxjerr njoftimin e saj ditën e sotme.

Audicioni do të zhvillohet në **datën 03.04.2024, ora 10:00, në sallën “Rifat Teqja” të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambilit Popullor.**

-Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje të certifikuar nga shteti i tij;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.
7. Të ketë njohuri minimalisht të 2 gjuhëve të huaja, të detyrueshme anglisht dhe italisht.

Të gjithë artistët e interesuar për pjesëmarrje në këtë audicion, duhet të dorëzojnë pranë sekretarisë së TKOBAP-së ose në adresën e postës elektronike zyrtare të TKOBAP sekretaria@tkob.gov.al deri në datën 27.03.2024, ora 16:30 dokumentacionin si vijon:

1. Një letër shprehje interesi për vendin vakant;
2. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;
3. Vërtetim të gjendjes shëndetësore ose një dokument ekuivalent me të;
4. Vërtetim të gjendjes gjyqësore ose një dokument ekuivalent me të;
5. Fotokopje të diplomës dhe listë notash të noterizuar në shtetin përkatës (**të ketë kryer studimet e larta në nivelin Master për oboe brenda ose jashtë vendit**);
6. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose një dokument ekuivalent me të;
7. Jetëshkrim (Curriculum Vitae) bashkëngjitur me foto dhe dokumentacionin e nevojshëm që vërteton: veprimtarinë ndër vite, Master class-e, Work shop-e, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, tituj artistikë si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën e tij artistike për vendin vakant për të cilin aplikon.

Oboe e dytë me detyrim Korno angleze:

Program i detyruar:

Koncert Mozart Do mazhor koha 1 dhe 2.

Vështirësi orkestrale oboe:

G. Verdi - Aida
Rigoletto
J. Brahms- concerto per violino e ork. koha e 2
M. Ravel - Le tombeau de couperin
R. Strauss - Don Giovanni
I. Stravinsky - Pulcinella balet
Korsakov - Scheherazade
Tchaikovsky - Simfonia 4 koha 2...
Arrethyesi Nr. 1 dhe 5
G. Bizet - Simfonia Do mazhor.

Korno angleze:

Program i detyruar:

Donizzeti Koncertino

Vështirësi orkestrale korno angleze:

Verdi - Rigoletto
Un ballo in maschera
Rossini – Vilhelm Tel Uverture

Shënim:

-Komisioni ruan të drejtën:

- 1. Të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.**
- 2. Nëse kandidatët nuk kanë shoqërues në piano me vete, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor do vendosë një shoqërues në piano në ditën e audicionit pasi të jetë lajmëruar paraprakisht nga kandidati në momentin e depozitimit të dokumentacionit.**

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën elektronike:
sekretaria@tkob.gov.al.

DREJTORE E PËRGJITHSHME

Abigeila Voshtina